



UNITED NATIONS
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

State Secretariat for Economic Affairs SECO



NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA

UDHËZUES PËR FERMERËT DHE NVM MBI PËRPUTHSHMËRINË ME STANDARDET ORGNIKE TË BE-SË DHE NOP





NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA: UDHËZUES PËR FERMERËT DHE NVM MBI PËRPUTHSHMËRINË ME STANDARDET ORGANIKE TË BE-SË DHE NOP

Nëse jeni një fermer që synon të eksportojë produktet organike në tregjet e huaja, është e rëndësishme të kuptoni dhe të zbatoni udhëzimet e eksportit organik të Bashkimit Evropian (BE) dhe Standardet Organike të Programit Nacional për Prodhimin Biologjik (NOP) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



PËRMBLEDHJE E STANDARDEVE ORGANIKE



Standardet Organike të BE-së

Standardet e BE-së promovojnë bujqësinë e qëndrueshme, ruajnë shëndetin e tokës dhe biodiversitetin, dhe sigurojnë prodhime cilësore për konsumatorët.



Programi Kombëtar Organik (NOP)

NOP rregullon prodhimin dhe përpunimin e produkteve organike në SHBA, duke mbrojtur integritetin e tyre dhe siguruar praktika të qëndrueshme dhe të përgjegjshme mjedisore.

ÇFARË ËSHTË ORGANIKE?



Produkte në përputhje me kërkesat e ligjit



Të certifikuar nga një organizëm i pavarur dhe i aprovuar

PËRFITIMET E CERTIFIKIMIT ORGANIK



Për fermerët

- » Akses në tregje dhe çmime më të mira
- » Praktika bujqësore të qëndrueshme
- » Kosto inputesh më të ulëta
- » Siguria dhe shëndeti



Për ambientin

- » Ruatja e biodiversitetit
- » Shëndeti i tokës
- » Ulje e ndotjes
- » Efekt pozitiv në mjedis dhe kushte klimatike



Për konsumatorët

- » Produkte më të sigurta
- » Zgjedhje të shëndetshme
- » Produkte më të ushqyeshme

Kushti i parë për të eksportuar produktet si organike, është certifikimi i këtyre produkteve sipas rregullores përkatëse.

KËRKESAT E CERTIFIKIMIT ORGANIK TË BE-SË



→ Menaxhimi i tokës dhe pjellorisë

- » Zbatimi i qarkullimit kulturor për të ruajtur strukturën dhe pjellorinë e tokës.
- » Përmirësimi i aktivitetit mikrobiologjik dhe balancimi i lëndëve ushqyese përmes mbjelljeve të ndërthurura dhe plehërimit organik.

→ Kontrolli i dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija

Zbatimi i metodave agroteknike dhe biologjike, si:

- » Lëshimi i insekteve grabitqare (p.sh. grerëzat parazitare kundër afidëve).
- » Përdorimi i kultivarëve rezistentë ndaj patogjenëve të zakonshëm.
- » Eliminimi mekanik i barërave të këqija (p.sh. me kositje, termokontroll ose me dorë).

→ Përdorimi i plehrave dhe amendamenteve

Aplikimi i lëndëve ushqyese organike, duke respektuar ciklin e bimëve:

- » Komposti i fermentuar si burim i qëndrueshëm i materies organike.
- » Pleh organik i dekompozuar për përmirësimin e strukturës së tokës.
- » Nxitës biologjikë të rritjes, si ekstrakte bimore dhe mikroorganizma të dobishëm.

→ Menaxhimi i ujit

Përdorimi i ujitjes me pika për:

- » Efikasitet më të lartë në përdorimin e ujit.
- » Reduktimin e avullimit dhe kullimit sipërfaqësor.
- » Optimimin e furnizimit me ujë sipas kërkesave të bimëve.

→ Menaxhimi i blegtorisë në sistemet organike

Sigurimi i mirëqenies dhe kushteve optimale për kafshët:

- » Lëvizshmëri e lirë në hapësira të përshtatshme.
- » Strehim higjienik dhe me kushte natyrore.
- » Ushqim ekskluzivisht organik dhe pa aditivë sintetikë.
- » Trajtim i bazuar në metodologji natyrore për mirëqenien e kafshëve.

→ Ndalimi i organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMG)

- » Përdorimi i farave, ushqimeve apo inputeve të modifikuara gjenetikisht është rreptësisht i ndaluar në sistemet organike.

Rezultati: Sigurimi i një sistemi bujqësor të qëndrueshëm, me produktivitet të lartë dhe ndikim minimal në mjedis.



KËRKESAT E CERTIFIKIMIT ORGANIK TË NOP



→ Përputhshmëria e të mbjellave dhe prodhimeve

- » Fermeri duhet të përdorë farëra të certifikuara organike, të adaptuara për klimën dhe tokën lokale.
- » Nuk lejohen inputet kimike sintetike gjatë gjithë ciklit vegetativ.

→ Menaxhimi i dëmtuesve, sëmundjeve dhe barërave të këqija

Shembuj të zatimit të metodave biologjike dhe të integruara për mbrojtjen e bimëve:

- » Përdorimi i insekteve grabitqare për kontrollin e dëmtuesve.
- » Aplikimi i biopesticideve dhe ekstrakteve bimësi si alternative natyrore ndaj pesticideve sintetike.
- » Menaxhimi mekanik i barërave të këqija përmes krasitjes, mbulimit të tokës dhe plehërimit jeshil.

→ Menaxhimi i lëndëve ushqyese dhe inputeve

Aplikimi i plehrave organike dhe substancave të miratuara sipas standardeve organike. Lejohen:

- » Komposti i fermentuar për pasurimin e tokës me materie organike.
- » Pleh natyral i maturuar për rritjen e pjellorisë së tokës.
- » Nuk lejohen nitratat sintetike, pesticidet kimike dhe rregullatorët sintetikë të rritjes.

→ Dokumentacioni dhe mbajtja e regjistrave

Mbajtja e shënimeve të detajuara për çdo hap të prodhimit përfshin:

- » Datat e mbjelljes dhe vjeljes.
- » Përdorimin e plehrave dhe inputeve.
- » Metodën e kontrollit të dëmtuesve.
- » Këto të dhëna janë thelbësore për gjurmueshmërinë e produkteve dhe certifikimin organik.



PROCESI I CERTIFIKIMIT ORGANIK

HAPAT



→ Kërkesa për Certifikim

- » **Aplikimi Fillestar:** Fermeri duhet të dorëzojë një aplikim fillestar për certifikim organik tek organi certifikues. Ky aplikim përfshin informacione mbi praktikën e fermës, tokën dhe historinë e përdorimit të lëndëve kimike.
- » **Planifikimi i inspektimit:** Pas dorëzimit të aplikimit, organi certifikues do të planifikojë një inspektim të fermës për të verifikuar përputhshmërinë me standardet organike.

→ Zbatimi i standardit/ Afatet kohore dhe periudhat e konvertimit për certifikim organik

- » **Për bimët vjetore** periudha e konvertimit është zakonisht 3 vjet. Kjo do të thotë se toka duhet të menaxhohet sipas praktikave organike për të paktën tre vjet përpara se prodhimi të mund të certifikohet si organik.
- » **Për bimët shumëvjeçare** (p.sh., pemët frutore), periudha e konvertimit është zakonisht 2 vjet para se të mund të konsiderohen organike.
- » Periudha e konvertimit zakonisht fillon nga data kur toka për herë të fundit është trajtuar me lëndë kimike të ndaluara.





→ Auditet dhe Inspektimet

- » Udhëzime për përgatitjen dhe kalimin e auditimeve të certifikimit.
- » Fermeri duhet të sigurohet që të gjithë dokumentacionet dhe shënimet janë të organizuara dhe të përditësuara. Kjo përfshin regjistrimin e aktiviteteve të përditshme të fermës, përdorimin e lëndëve të para, dhe metodave të menaxhimit.
- » Të gjithë punonjësit duhet të jenë të informuar për procesin e certifikimit dhe të jenë të përgatitur për të përgjigjur pyetjeve të auditorëve.
- » Fermeri mund të kryejë një auditim të brendshëm për të identifikuar ndonjë mangësi përpara auditimit zyrtar.

→ Lista e dokumenteve të kërkuara

- Regjistrimet e mbjelljeve dhe korrjeve.
- Faturat dhe dokumentet e blerjes së lëndëve të para.
- Shënimet e përdorimit të pesticideve dhe plehrave.
- Shënimet e inspektimeve të mëparshme dhe veprimeve korrigjuese.
- Certifikatat e produkteve të përdorura (p.sh., fara organike).

Dokumentet duhet të mbahen në një vend të sigurt dhe të organizuar, qoftë në formë fizike apo digjitale, dhe të jenë lehtësisht të aksesueshme gjatë inspektimeve.

→ Rinovimi vjetor i certifikimit

Fermerët e certifikuar duhet të kalojnë një inspektim vjetor për të rinovuar certifikimin e tyre organik. Gjatë këtij inspektimi, inspektori do të verifikojë që praktikat organike vazhdojnë të ndiqen dhe se nuk ka ndonjë shkelje të standardeve organike.

→ Veprimet korrigjuese dhe ankesat

- » Nëse gjatë inspektimit zbulohen shmangie nga standardet organike, fermeri duhet të ndërmarrë veprime korrigjuese dhe të japë prova për përputhshmërinë e rikthyer për të ruajtur certifikimin.
- » Fermerët kanë të drejtë të bëjnë ankesa nëse nuk janë dakord me vendimet e organit certifikues.

Në rast të eksportit të produkteve organike në BE ose Zvicër, këto produkte duhet të shoqërohen nga një Certifikatë Inspektimi (COI), e cila konfirmon se produkti është prodhuar në përputhje me rregullat e prodhimit organik ekuivalent me rregulloret organike të BE ose USDA.

Ky dokument lëshohet nga trupa certifikuese e operatorit i cili kryen hapin e fundit të përpunimit të një loti (ruajtje, përpunim, paketim, etiketim, vulosje në paketime apo mjete). Brokerat, të cilët nuk trajtojnë fizikisht produktin, nuk konsiderohen “eksportues”. Col-t per EU, lëshohen në një aplikacion online, Traces, dhe firmosur në mënyrë elektronike. Col duhet të jetë marrë përpara se ngarkesa të largohet nga vendi i eksportit.



**GLOBAL QUALITY
AND STANDARDS PROGRAMME**

NJË INICIATIVË GLOBALE

GQSP ndihmon prodhuesit e vegjël për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre, të përbushin standardet ndërkombëtare dhe të eksportojnë nëpër botë



**UNITED NATIONS
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO